

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Veprimtaritë e lëndës së drurit

ID 7.10/b “Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “Rodi Art Wood” Sh.p.k.

NIPT: L044040040

VENDNDODHJA: Lagjja 8, Rruga Banda Vatra, Rruga e Tullës, Korce.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “**Rodi Art Wood**” Sh.p.k. është regjistruar ne QKB me date **04/08/2010**, me forme ligjore si **Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuara**, me NIPT **L044040040** dhe administrator **Gentol Panariti**.

“**Rodi Art Wood**” Sh.p.k. kryen aktivitete si perpunimi i lendeve te drurit dhe nenprodukteve te tij, dhe cfaredo lloj materiali e pajisje me baze druri, Prodhim, tregtim, perpunim e produkteve te drurit me shumice dhe pakice jashte dhe brenda territorit te vendit. Transport i materialeve te drurit dhe nenprodukteve te tij brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, transport dhe shitje me shumice dhe pakice te druve te zjarrit.

Subjekti do te aplikojë për leje mjedisi Tip B

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 datë 14.07.2011, të ndryshuar:

Veprimtaritë e lëndës së drurit;

ID 7.10/b “Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
 - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
 - Ndikimi ne flore/faune;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
 - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim ne peizazhin e zones;

- ❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit eshte: **Lagja 8, Rruga Banda Vatra, Rruga e Tulles, Korce.**

Objekti identifikohet sipas ortofotos se meposhteme:



Koordinatat sipas Gauss Kruger

Nr.	X	Y
1.	4480537.4	4497515.89

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

Veprimtaritë e lëndës së drurit;

ID 7.10/b “Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

Procesi teknologjik I perpunimit te drurit

Lenda e pare kalon ne dhomat e tharies:

Tharja e drurit eshte proces i domosdoshem qe duhet ndermarre para procesit te perpunimit mekanik te drurit, kjo behet per faktin se me tharjen e drurit permiresohen ne menyre te dukshme cilesite e tij. Druri si material higroskopik nuk mund te perdoret, nese ka teper lageshti. Atij duhet ti largohet sasia e tepert e lageshtise, d.m.th. ne dru mund te mbetet vetem aq lageshti sa i duhet, sepse ne kete rast ai do te merr lageshti prej ajrit qe e rrethon. Pra druri nuk duhet te kete as me shume e as me pak lageshti se sa i nevojitet atij ne mesin ku eksploatohet. Tere kjo eshte e nevojshme, sepse kur druri merr lageshti ai bymehet dhe anasjelltas kur leshon lageshti ai tkurret. Me ndryshimin e dimensioneve druri e pengon apo e bene te pa mundur funksionimin e pjeseve te prodhimit, sepse shume shpejt shkatërrohen i tere prodhimi.

Pas tharjes ai I nenshtrohet proceseve te ndryshe si sharrimi, ferkimi, gdhendje, zdrukthim dhe tregtohet.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

SHKARKIME NE AJER

Emetime ne ajer nga ky instalim mund te vijne nga proceset qe kryhen ne aktivitet: makineria e prerjes se drurit, e perpunimit, makineria e zmerilimit.

SHKARKIME NE UJERA

Ky aktivitet nuk perdor ujin gjate proceseve teknologjike. Nuk ka shkarkime te ujerave teknologjik ne mjedisin perreth. Mund te permendim vetem ujerat higjiëno-sanitare, te ambjenteve te tualeteve dhe larjes e pastrimit te ambjenteve te ounes. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

SHKARKIME NE TOKE

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjenteve te perstatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe kapanone te mbuluara.

ZHURMA DHE VIBRIME

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga makineria prerese e drurit, sharrimit, perpunimit, zmerilimit, zmusimit etj. Proceset e prodhimit shoqerohen me clirim zhurme, por nuk vleresohen ne nivele shqetesuese per zonen, vetem per ambientet e punes. Per kete operatori eshte kujdesur qe punonjesve t'u siguroje veshje mbrojtese.

MBETJE

Gjenerohen mbetje te ngurta te tilla si: mbetje druri, copa melamine, copa MDF, tallash pluhur, mbetje, mbetje nga aktiviteti I punonjesve si leter, karton, qelq etj.

Tallashi mund te perdoret per prodhimin e melanines, ose jeper per personat e interesuar si lende djegese, ose si aksesor per stallat e pleh organik.

Mbetjet e tjera si mbetjet e drurit, melaninen etj., jepen per personat e interesuar per to.

Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat I aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren konteniere hermetike qe te evidentohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimatike.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negative ne flore apo faune.

NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

SUBJEKTI

“Rodi Art Wood” Sh.p.k.

Administrator

Gentol Panariti